



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 14 Korrik 2021

Nr: 103

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 59, TË PARAQITUR NË KQZ NË
DATËN 12.07.2021

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 14.07.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Kryesues
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Organizata “Qëndresa Qytetare”

OBJEKTI: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 59, të depozituar nga Organizata “Qëndresa Qytetare” me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 423, datë 05.07.2021, ‘Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit ndaj kandidates për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”



BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 60 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Rrethanat e çështjes:

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në datën 17.03.2021, nëpërmjet e-mail është raportuar një denoncim nga Organizata “Qëndresa Qytetare”, me pretendimin se në ambientet e shkollës së mesme të bashkuar “Shëmri” Kukës, është bërë prezantimi i kandidatës për deputete të Partisë Socialiste, zj. Gerta Duraku, në kundërshtim me nenin 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator.

Në cilësinë e provës Organizata “Qëndresa Qytetare” ka vendosur në dispozicion një link të rrjetit social “Facebook” në të cilin sipas saj, janë shpërndarë foto nga takimi, objekt i këtij denoncimi

- Linku: <https://www.facebook.com/1012875545404246/posts/5487957724562650/>

2. Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3405 prot., datë 07.04.2021, i ka kërkuar Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, informacion sqarues në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti, të kandidatës për deputete, zj. Gerta Duraku, në ambientet e administratës arsimore.

3. Me shkresën nr. 343/1 prot., datë 19.04.2021, administruar me tonën me nr. 3405/1 prot., datë 20.04.2021, Drejtori i zyrës Vendore Arsimore Kukës, zj. Dashurie Hasa, ka kthyer përgjigje nëpërmjet së cilës bën me dije prezantimi i kandidatës është zhvilluar në ambientet e jashtme të shkollës së mesme, pas orës 16:00, sikurse dhe kandidatët e forcave të tjera politike

4. Me shkresën nr. 4517, datë 5.5.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është adresuar sërish këtij institucioni, për t’i vënë në dispozicion fotot e e aktivitetit të zj. Duraku, paraqitur në cilësinë e provës nga denoncuesi Qendresa Qytetare dhe për t’i kërkuar risqarim nëse këto foto në çmimin e tyre, janë apo jo ambiente të shkollës së mesme të bashkuar “Shëmri” Kukës.



5. Me shkresën nr. 343/3 prot., datë 19.05.2021 ,protokolluar me tonën me nr. 4917/1 prot., datë 21.05.202, drejtori i Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, zj. Hasa ka kthyer përgjigje prezantimi i kandidates është bërë në ambientin privat të z. Avdyl Brija dhe fotot e publikuara për këtë takim i përkasin këtij ambienti. Bashkëlidhur shkresës, zj. Hasa ka dërguar dhe konfirmimin e z. Brija gjithashtu dhe konfirmimin e administratorit të njësisë administrative Malzi.
6. Nisur nga dy përgjigjet e Zyrës Vendore Arsimore, Kukës mbi këtë aktivitet si dhe duke marrë në analizë linkun e vënë në dispozicion nga denoncuesi organizata “Qëndresa Qytetare” si elemente të vetme provuese të këtij denoncimi, KSHZ vlerëson se e ka të pamundur të identifikojë nëse fotot e publikuara në rrjetin social Facebook, përbëjnë ose jo aktivitet të zhvilluar në ambientet e Shkollës së Mesme “Shëmri ” Kukës, për këto arsye, me vendimin nr. 423, datë 05.07.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendosi përfundimin e shqyrtimit administrative të denoncimit ndaj kandidates për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, për arsye se nuk konstatohen elemente të shkelje së dispozitave të nenit 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
7. Në datën 12.07.2021, Organizata “Qëndresa Qytetare”, ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) me objekt “Kundërshtimi i vendimit nr. 423, datë 05.07.2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) është organi kompetent për të shqyrtuar kallëzimet e paraqitura nga personat fizikë/juridikë, sipas pikës 2 të nenit 9 të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Lidhur me ankesën në fjalë të paraqitur nga Organizata “Qëndresa Qytetare”, me vendimin nr. 423, datë 05.07.2021, KSHZ ka vlerësuar se ky ankim është objekt shqyrtimi nga ana e tij



dhe referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, KSHZ ka çmuar se të dhënat e paraqitura nga denoncuesi Organizata “Qendresa Qytetare”, përbënin indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

2. Për sa më sipër, KSHZ ka nisur hetimin administrativ për të arritur në përfundimin nëse kemi shkelje të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator apo jo. Për nevoja të hetimit, KSHZ ka kërkuar informacion me anë të shkresave drejtuar Zyrës Vendore Arsimore Kukës për të marrë më shumë sqarime lidhur me zhvillimin e aktivitetit të pretenduar nga subjekti ankues, por siç rezultoi nga provat e administruara nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), ka një mospërputhje dhe paqartësi lidhur me përgjigjet e dhëna nga Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, ku fillimisht me shkresën nr. 3405/1 prot., datë 20.04.2021 bëhet me dije se prezantimi i kandidatës për deputete është zhvilluar në ambientet e jashtme të shkollës së mesme, pas orës 16:00, ndërsa në një moment të dytë, me shkresën nr. 4917/1 prot., datë 21.05.2021, i njëjti subjekt ka deklaruar se prezantimi i kandidatës është bërë në një ambient privat që i përket z. Avdyl Brija.
3. Nisur nga kjo, anëtarët e KAS, pasi morën dhe konfirmimin nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), konstatuan se në procedurën e shqyrtimit administrativ të ndjekur nga KSHZ, nuk ishin thirrur si palë për të patur mundësi të shprehnin qëndrimet dhe pretendimet e tyre, as Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, as Drejtori i shkollës së mesme ‘Shëmri’ dhe as kandidatja për deputete zj. Gerta Duraku.
4. Referuar ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, palët kanë disa të drejta procedurale për të marrë pjesë në hetimin administrativ për të dhënë shpjegime për akuzat që i bëhen. KAS konstaton se Zyra Vendore Arsimore, Kukës dhe kandidatja për deputete zj. Duraku, nuk janë trajtuar si palë procedurale, duke u shkelur parimi i një procesi ligjor të drejtë.
KSHZ ka vendosur se kandidatja për deputete zj. Gerta Duraku nuk përfshihet në rrethin e subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, por nuk ka analizuar përgjegjësinë për shkelje eventuale të detyrimeve specifike të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Për këtë arsye, kandidatja për deputete duhet gjithashtu të thirret dhe t’i garantohen të drejtat sipas Kodit të Procedurave Administrative.



5. Neni 81, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative përcakton se “*organi kompetent kërkon dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji*”. Në rastin konkret rezulton se KSHZ është mjaftuar vetëm me shkëmbimin e korrespondencës me Drejtorin e Zyrës Vendore Arsimore, Kukës, pa hetuar më shumë për të mbledhur prova dhe fakte që do të vërtetonin shkeljen ose jo të Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. KAS për këtë arsye konstaton se hetimi i kryer nga ana e KSHZ nuk është i plotë dhe i gjithanshëm, pasi nuk janë shteruar të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore për të siguruar provat dhe faktet e nevojshme për çështjen.
6. Referuar nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative, *pas përfundimit të procedurës hetimore, (...) palët e interesuara kanë të drejtë të shprehen përpara marrjes së vendimit përfundimtar*. Si palë e interesuar në procedimin administrativ ka të drejtë të marrë pjesë çdokush që ka interes të ligjshëm, bazuar në nenin 44, pika 1 e Kodit të Procedurave Administrative. KAS çmon se subjekti ankues, Organizata “Qëndresa Qytetare” shfaq një interes të ligjshëm në këtë procedim duke qenë dhe kallëzuesi i denoncimit dhe për këtë arsye duhej thirrur si palë e interesuar në procedimin administrativ të ndjekur nga KSHZ.

PËR KËTO ARSYE:

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Shfuqizimi e vendimit nr. 423, datë 05.07.2021 “Për shqyrtimin administrativ të kallëzimit ndaj kandidatës për deputete zj. Gerta Duraku dhe Zyrës Vendore Arsimore Kukës, për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”;
2. Riçeljen e hetimit administrativ të plotë e të gjithanshëm nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe Kodin e Procedurave Administrative, duke u

garantuar të drejtat e palës në procesin administrativ kandidates për deputete, Drejtorisë së Zyrës Vendore Arsimore Kukës dhe drejtorit të shkollës së mesme “Shëmri”, Kukës.

3. Të thirret në këtë proces si palë e interesuar kallëzuesi Organizata “Qëndresa Qytetare”;
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

Elvin LAKO - Kryesues

Elvis ÇEFA - Anëtar

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar